

NEWSLETTER PROGRAMI CONNECT ALBANIA

2021

Nr. 7



CONNECT
ALBANIA

Connect Albania (CA)

Shënim për lexuesin:

Connect Albania po pritët gjithnjë e më mirë nga komuniteti i Diasporës Shqiptare në Itali dhe kemi kënaqësinë të shpallim dy Agjente Zhvillimi të cilat sapo janë çertifikuar gjatë kësaj jave në datë 19 Maj 2021, Zj. Denada Zoto dhe Zj. Edvina Plaka, të cilat me punën e tyre do të tërheqin dhe lehtësojnë hyrjen e investimeve të huaja në Shqipëri. Në këtë numër të buletinit të Connect Albania, ne ju prezantojmë Zj. Denada Zoto e cila do të hyjë edhe në Regjistrin Publik të Agjentëve të Interesuar të Zhvillimit i publikuar në faqen e Connect Albania:

<https://www.adbc.al/en/public-register-of-interested-development-agents/>

Zj. Denada Zoto

Zj. Denada Zoto lindi në Tiranë në vitin 1988. Pas përfundimit të shkollës së mesme në Shqipëri, ajo u zhvendos në Itali ku filloi studimet për Bankë dhe Financë në Universitetin e Breshias. Rezultatet shumë të mira bënë që ajo të përfshihej dhe punonte në institucione të ndryshme financiare. Gjatë 7 viteve të fundit ajo ka punuar për Südtirol Bank si konsulente financiare dhe broker. Në mënyrë të veçantë aktiviteti i saj përqendrohet në menaxhimin e kursimeve dhe kapitalit të sipërmarrësve, investitorëve dhe ndërmarrjeve me anë të realizimit të iniciativave të investimit në bursë.

Përveç aktivitetit kryesor, ajo është mjaft e përfshirë në aspektin profesional dhe aktivitetet e Diasporës Shqiptare në Itali. Ajo ka krijuar rrjetin e profesionistëve në Breshia ku marrin pjesë profesionistë dhe sipërmarrës nga Diaspora Shqiptare. Ky rrjet i ka shërbyer shkëmbimit midis anëtarëve të tij por edhe për të këshilluar dhe referuar shqiptarët që diplomohen në Itali drejt tregut të punës. Një iniciativë tjetër e saj në mbështetje të Diasporës Shqiptare, është edhe projekti "Financa flet shqip" në kuadër të të cilit ajo ofron këshilla të vlefshme dhe konsulencë për mundësitë e investimeve financiare për një numër prej më shumë 40 sipërmarrësish shqiptarë në rajonin e Lombardisë. Duke pasur një aktivitet intensiv dhe të vazhdueshëm me komunitetin e biznesit të Diasporës Shqiptare, ishte diçka e natyrshme që ajo të aplikonte për tu bërë Agjente e Interesuar Zhvillimi në programin Connect Albania.

"Gjatë gjithë viteve që kam punuar në Itali, kam qenë mjaft e përfshirë duke ndihmuar sipërmarrësit shqiptarë drejt suksesit të tyre në Itali; është koha që ti ndihmoj ata të konsiderojnë realizimin e investimeve në atdheun tonë – kjo është një nga rrugët e duhura për ta bërë Shqipërinë një vend të zhvilluar dhe më të mirë"



Mekanizmi Connect Albania është një pjesë e rëndësishme e programit "Angazhimi i Diasporës në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë". Ai do të kontribuojë në rritjen e investimeve në Shqipëri, që do të krijojë vende të reja pune dhe do të ndikojë në rritjen ekonomike. Programi zbatohet nga Misioni në Shqipëri i Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) – Agjencia e Migrimin e OKB-së, me financimin e Ministrisë Italiane për Punët e Jashtme dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrin e Shtetit për Diasporën të Shqipërisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si edhe Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS).



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTRI I SHITËTIT PËR DIASPORËN



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË



CONNECT
ALBANIA



IOM
UN MIGRATION



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



RRJETI
I PROFESIONISTËVE
TE DIASPORËS